

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1

Version: 2

LIGHTKOLL C2TES2 I BARDHE**PËRSHKRIMI**

Ngjitës me bazë çimentoje, me peshë të lehtë, me performancë të lartë, shumë i deformueshëm/elastik, me kohë të zgjatur punueshmërie dhe pa rreshkitshmeri vertikale. I përshtatshëm veçanërisht për ngjitjen e pllakave me format të madh, gres-porcelanit, qeramikës, klinkerit, mozaikëve dhe gurëve natyralë të qëndrueshëm ndaj lagështisë.

Produkti është i përbërë nga, rëra kuarci dhe dolomiti me granulometri të pergjedhur, rezina në perqindje të lartë dhe aditivë specifike, të cilët i japin produktit karakteristika të shkelqyera në forcë ngjitëse, qëndrueshmëri, elasticitet dhe lehtësi aplikimi.

Konsum rreth 40% më i ulët se ngjitësit standardë me bazë çimentoje, falë peshës së lehtë dhe rendimentit më të lartë. Një paketim 15 kg mund të mbulojë afërsisht të njëjtën sipërfaqe pune si një paketim 25 kg i një ngjitësi standard, në varësi të formatit të pllakës, llojit të mallës dhe nivelit të suportit.

Kur përzihet me ujë, LIGHTKOLL C2TES2 formon një masë homogjene, kremoze dhe të lehtë për aplikim. Falë rrëshkitshmërisë zero, produkti mundëson vendosjen më të qëndrueshme të pllakave në sipërfaqe vertikale.

LIGHTKOLL C2TES2 ka aftësi të mirë për të përballuar deformimet ndërmjet nënshtresës dhe pllakës, duke e bërë të përshtatshëm për aplikime ku kërkohet elasticitet i lartë, qëndrueshmëri ndaj lëvizjeve të kontrolluara të nënshtresës dhe performancë afatgjatë.

Produkti ofron kohë të gjatë hapjeje dhe korrigjimi, duke e bërë vendosjen e pllakave më të lehtë dhe më praktike, sidomos në sipërfaqe të mëdha, fasada, tarraca dhe ambiente ku kërkohet më shumë kohë për rregullimin e pozicionit të pllakës.

KLASIFIKIMI SIPAS STANDARTIT

Ngjitës për pllaka me bazë çimento (C), me forcë ngjitëse të përmirësuar (2), rezistent ndaj rreshkitjes (T), kohë punueshmërie e gjatë (E) dhe i deformueshëm / elastik (S2).

I klasifikuar si ngjitës C2TES2 sipas standartit EN 12004.

LIGHTKOLL C2TES2 ka emetime shumë të ulëta të VOC-ve, (komponimeve organike të avullueshme), duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë së aplikatoreve. sipas kërkesave EC1 Plus.

KARAKTERISTIKAT

1. Ngjitje e lartë dhe performancë e përmirësuar mbi suporte të përshtatshme për ngjitje pllakash.
2. Peshë e lehtë, që e bën produktin më të lehtë për transport, përzierje dhe aplikim.
3. Punueshmëri shumë e mirë dhe aplikim i lehtë me mallë të dhëmbëzuar.
4. Kontakt i mirë me pjesën e pasme të pllakës.
5. Rrëshkitje vertikale 0 gjatë vendosjes së pllakave në mur.
6. Kohë e zgjatur hapjeje për aplikim më praktik në sipërfaqe të mëdha.
7. Konsum rreth 40% më i ulët se ngjitësit standardë me bazë çimentoje, falë peshës së lehtë dhe rendimentit më të lartë.
8. Fleksibilitet/deformueshmëri e lartë S2, e përshtatshme për aplikime teknike dhe sipërfaqe me lëvizje.
9. Rezistencë ndaj lagështisë, kushteve atmosferike dhe ndryshimeve normale të temperaturës.
10. I përshtatshëm për pllaka me format të madh deri në 200 cm.
11. Konsistencë homogjene pas përzierjes me ujë.
12. I përshtatshëm për aplikime në mure dhe dysheme.
13. I përshtatshëm për ambiente të brendshme dhe të jashtme.
14. I përshtatshëm për fasada, tarraca dhe ballkone.
15. I përshtatshëm për dysheme me ngrohje.
16. I përshtatshëm mbi shtresa hidroizoluese të përshtatshme, si Hidrofix II.
17. I përshtatshëm për gres-porcelan, qeramikë, klinker, mozaikë, pllaka me absorbim të ulët, mermer dhe gur natyral të qëndrueshëm ndaj lagështisë.
18. Emetime shumë të ulëta VOC, sipas kërkesave EC1 Plus.

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1

Version: 2

LIGHTKOLL C2TES2 I BARDHE**FUSHA E APLIKIMIT**

LIGHTKOLL C2TES2 është i përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikës në suporte me bazë çimentoje, gres-porcelanit, klinkerit, mermerit, pllakave të gurit, mozaikëve, pllakave me absorbim të ulët dhe pllakave me spesor të lartë.

Produkti përdoret për dysheme dhe mure, në ambiente të jashtme dhe të brendshme, si dhe mbi shtresa hidroizoluese të përshtatshme, për shembull Hidrofix II.

I rekomandueshëm për fasada të larta, tarraca, ballkone, ambiente me ngrohje qendrore ose ngrohje nën dysheme, si dhe për ambiente që i nënshtrohen vibrimeve, shtypjeve të vazhdueshme dhe ndryshimeve termike.

Për shkak të elasticitetit dhe deformueshmërisë së lartë, LIGHTKOLL C2TES2 është i përshtatshëm për ngjitjen e pllakave me dimensione të mëdha dhe për aplikime ku kërkohet siguri më e lartë e sistemit të ngjitjes.

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave me format 5-200 cm.

Për tarraca të ekspozuara, fasada të larta ose zona me kërkesa të larta ndaj ujit, produkti duhet të përdoret si pjesë e një sistemi të përshtatshëm hidroizolimi dhe aplikimi, sipas projektit teknik.

MENYRA E PERGATITJES SE PERZIERJES

Përzieni 6.5-7 litra ujë të pastër me 15 kg LIGHTKOLL C2TES2. Përzierja bëhet me përzierës elektrik me xhiro të ulëta, derisa të formohet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Masa e krijuar lihet në qetësi për rreth 10 minuta dhe më pas përzihet përsëri përpara përdorimit.

Koha e punueshmërisë së përzierjes është rreth 4 orë në kushte normale temperature dhe lagështie. Mos shtoni ujë pasi përzierja ka filluar të ngurtësohet.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra, jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhen të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike dhe të sperkatën me ujë.

APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë.

Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35 minuta për temperatura 23°C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit. Pllakat vendosen mbi ngjitësin e freskët duke ushtruar presion të mjaftueshëm për të siguruar kontakt të plotë. Për pllaka me format të madh, sipërfaqe të jashtme, fasada, dysheme me ngarkesë ose zona me prani uji, rekomandohet aplikimi i ngjitësit edhe në pjesën e pasme të pllakës për mbulim maksimal.

Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të formojë sipërfaqje të lme. Në të kundërt atëherë është e nevojshme që të kalohet dhe njëherë malla mbi kollë. Nuk këshillohet që pllakat të vendosen me fuga të puthitura. Pllakat vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme me dimensionet e tyre.

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1

Version: 2

LIGHTKOLL C2TES2 I BARDHE**TË DHËNAT TEKNIKE**

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 15 kg në paleta 1080 kg
Ngjyra:	E bardhë
Konsumi për formate të vogla:	1.5-2 kg/m ²
Konsumi për formate të mëdha:	2-3 kg/m ²
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e Magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa Vëllimore:	1.2 gr/cm ³
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa A1
Ujë për përzierje:	6.5-7 litra ujë për 15 kg
pH i përzierjes:	13
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Koha e korigjimit:	35-40 min
Mbushja e fugave në mure:	Pas 8 deri 12 orësh
Mbushja e fugave në dysheme:	Pas 24 orësh
FN* pas 28 ditësh:	≥0,5 N/mm ²
FN* pas zhytjes në ujë:	≥0,5 N/mm ²
FN* pas reaksionit nga ngrohja:	≥0,5 N/mm ²
FN* pas cikleve ngrirje-shkrirje:	≥0,5 N/mm ²
FN* pas 20 min:	≥0,5 N/mm ²
I shkelshëm:	Pas 24 orësh
Rrëshkitshmëria:	≤0,5 mm
Deformueshmëria:	5 mm

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1

Version: 2

LIGHTKOLL C2TES2 I BARDHE**KUJDES!**

1. Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalesim ose përspejtim në tharje të produktit).
2. Për formate pllakash shumë të mëdha, aplikoni shtrim të dytështë të kollës në pllakë dhe bazament.
3. Mbroni bazamentin për të paktën 24 orë pas aplikimit të ngjitësit, nga shirat e rrëmbyer si dhe nga ngricat dhe rrezet e forta të diellit.
4. Për formate të mëdha pllakash vendosja e fugës do të bëhet 3-5 ditë pas ngjitjes vetëm nëse është bërë hidroizolimi
5. Mos e aplikoni mbi suporte të paqëndrueshme, të pamaturuara, me pluhur, vaj, yndyrë ose mbetje që pengojnë ngjitjen.
6. Mos e përdorni drejtpërdrejt mbi dru, metal, PVC, gomë, linoleum ose suporte shumë të lëvizshme pa sistem të përshtatshëm paraprak.
7. Mos tejkaloni raportin e rekomanduar të ujit dhe trashësinë maksimale të aplikimit.
8. Për aplikime speciale, fasada të larta, pishina, rezervuarë ose sipërfaqe me ngarkesa të larta, rekomandohet verifikim teknik dhe sistem i plotë aplikimi